



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për prandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenin 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Komisioni shtetëror duke vepruar pas denoncimit anonim me akuaz për ekzistim të konfliktit të interesave në senacën e 46-të, vazhdimin e parë të mbajtur me datë 19.02.2020, morri

### VENDIM

Denoncimi për ngritje të procedurës për vërtetim të gjendjes së konfliktit të interesave me numër 09-1976/1 me datë 25.03.2019, dorëzuar nga paarshtues i panjohur, RREFUZOHE. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent për lëndën me numër 09-1976/1 me datë 24.03.2019. Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për këtë lëndë, por edhe për lëndët tjera me akuza të ngjashme ose të njëjta për punësime të realizuara sipas Ligjit për marrëdhënje pune vërtetoi se edhe pse ekzistonë bazë për dyshime për ndikim gjatë punësimit, nuk ekzistojnë mekanizma ligjore për anulim të konkursit ose shqiptimit të sanksioneve ndaj personave përgjegjës në institucionet. Mbikqyrjet e realizuara gjatë procedurave të punësimeve sipas Ligjit për marrëdhënje pune nga ana e inspektoratit kompetent, gjithashtu nuk flasin për procedura joligjore gjatë punësimeve.

Lënda me numër 09-1976/1 me datë 25.03.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

### SQARIM

Lënda me numër 09-1976/1 me datë 25.03.2019 e formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur kundër më tepër personave, me akuza të ndryshme dhe atë se drejtoresha e dhomës ..... së RMV ....., nuk ka dorëzuar flet ankesë deri tek KSHPK, si dhe akuza për ekzistimin e nepotizmit gjatë punësimit të më tepër personave të afërt të ish-dekanëve të fakulteteve, profesorë të rregullt dhe persona tjerë nga Universiteti Shtetëror "Goce Dellçev" në Shtip, gjatë periudhës 2017 dhe 2018.

Pas shqyrtimit të denoncimit, KSHPK vërtetoi se në përputhje me nenin 82 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave personi ..... nuk ka bazë që deri tek KSHPK të dorëzon formular – listë anketuese për interesa, me çka akuzat nga denoncimi nuk janë vërtetuar.

Nga ana tjetër, në lidhje me personat e denoncuar të punësuar në universitetin e përmendur, për të cilët në denoncim qëndron se janë të afërt me profesorë të rregullt dhe ish dekanë nga universiteti i njëjtë dhe se janë të punësuar gjatë periudhës 2017 dhe 2018, KSHPK vërtetoi se në përputhje me Ligjin për kundërvajtje është bërë vjetërsim i veprimit.

Duke pasë parasysh të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent, prandaj vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarё: Biljana Ivanovska

Pas pёrfundimit тё KSHPK  
Pёrpunoi: K. Z., кёshilltarё  
Miratoi: K. N., anёtar i KSHPK

